

VENDIM
Nr.542, datë 27.7.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LEJES PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN
E LINJËS TREGTARE, TË INTERKONJEKSIONIT ME RRYMË TË VAZHDUAR,
NDËRMJET KALLMET/LEZHË (SHQIPËRI) DHE ZAPPONETA/MANFREDONIA
(ITALI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e lejes nr.4/1, të datës 7.12.2009 “Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, ndërmjet Kallmet/Lezhë (Shqipëri) dhe Zapponeta/Manfredonia (Itali)”, miratuar me vendimin nr.31, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, ndërmjet Kallmet/Lezhë (Shqipëri) dhe Zapponeta/Manfredonia (Itali)”, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i katërt ndryshohet, si më poshtë vijon:
“-Puna për ndërtimin e linjës duhet të fillojë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtyre ndryshimeve të kësaj lejeje.”.
2. Paragrafi i pestë ndryshohet, si më poshtë vijon:
“-Leja hyn në fuqi pas miratimit të këtyre ndryshimeve nga Këshilli i Ministrave.”.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha